

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues, Agim Ademi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit S.E. nga ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat B.I., nga ..., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan,- Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I. nr.77/2017, të datës 30.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 10.05.2017, bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

S.E., nga i ati F., i lindur më ..., në ... ku edhe jeton tani ne rrugën ” ... “ nr. ..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, i papunë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ESHTE FAJTOR

Se në kohë të papërcaktuar në mënyrë të paautorizuar dhe në shkelje të ligjit të zbatueshëm për armët, ka siguruar dhe mbajtur në pronësi armë të zjarrit dhe atë një revole të markës ‘ ... ‘, me numër serik ..., dhe me dy fishekë të së njëjtës armë, e cila armë me datë 28.03.2017, i është konfiskuar nga ana e pjesëtareve të policisë së Kosovës .

Me çka ka kryer veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7,17,21,46,51,73, 75, 76 dhe 114, 372 par.4 dhe 374.3 të KPRK-ës, dhe neneve 365 dhe 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin S.E., e dënon me dënim me gjobë në shumën prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilin dënim me gjobë i akuzuari do të e paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim burgu llogaritur nga 20 euro për një ditë burgim.

Të akuzuarit S.E. i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës së zjarrit edhe atë një revole e tipit " ... ", me numër serik ...

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej nga 25 (njëzetë e pesë) euro ,si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka paraqitur aktakuzë PP.I. nr.77/2017, të datës 30.03.2017, kundër të akuzuarit S.E. nga ... për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuarit armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës, të cilin sipas detyrës e mbron avokat B.I. nga ..., ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritor sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan – Departamenti për Krime të Rënda Afrim Shefkui, fillimisht mbeti në tërësi pran aktakuzës dhe pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarit deklaroi se në rastin konkret ekzistojnë rrethana lehtësuese me rastin e matjes së dënimit, duke qenë se i njëjti e ka pranuar fajësinë për veprën penale të bërë dhe është zotuar se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale dhe se dënimi me gjobe, do ta arrin qëllimin e dënimit .

Mbrojtësi i të akuzuarit S.E., avokat B.I., shtoi se duke u bazuar në pranimin vullnetar të fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës nga i mbrojturi im, i propozoi kryetarit të trupit gjykues që duke pas parasysh rrethanat se i akuzuari e ka pranuar fajësinë në baza vullnetare i cili pranim ishte real me çka tregon se i mbrojturi im është penduar për këtë vepër penale, pastaj rrethanat personale të mbrojturit tim, fakti se i njëjti është familjar, është i pa punësuar, i propozoj Gjykatës që të i konsideroj si rrethana veçanërisht lehtësuese për të mbrojturin tim dhe t'i aplikoj dispozitat e nenit 75 dhe 76 te KPRK-se, ashtu që të mbrojturit tim ti shqiptohet një dënim minimal me bindje se edhe me një dënim të tillë do te arrihet qëllimi dënimit .

I akuzuari S.E., fillimisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë e më pas shtoi se më vjen shumë keq për veprën e kryer penale, pendohem thellë dhe premtoi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Andaj kërkoi nga Gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë që është e mundur.

Gjykata analizoi provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës si: formularë prone i datës 28.03.2017, vërtetim mbi konfiskimin e një Revole të tipit “ ... ” i datës 28.03.2017, foto dokumentacionit i cili gjendet në shkresat e lëndës si dhe me vet pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, erdhi në përfundim se i akuzuari S.E., në mënyrë të paautorizuar në shkelje të ligjit të zbatueshëm, ka mbajtur në pronësi armën e zjarrit edhe atë një Revole të tipit “ ... ”, me numër serik ..., të kalibrit 7.65 ngjyre e zezë-ari, me çka ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, në posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethana lehtësuese gjeti se i akuzuari S.E. e ka pranuar fajësinë duke shprehur keqardhje të thellë, pati sjellje të mira në Gjykatë, dhe premtimi i tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh rrezikshmërinë shoqërore duke qenë se posedimi i pa autorizuar i armës paraqet rrezik për popullatën. Në prezencë të rrethanave të shumta lehtësuese e si rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimit e fajësisë, të akuzuarit S.E., i është shqiptuar një dënim sikurse në dispozitiv, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-ës.

Të akuzuarit S.E. i shqiptohet edhe dënimi plotësues konfiskimi i armës së zjarrit edhe atë një revole të tipit “ ... ”, me numër serik ...

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr.81/2017 Me datë: 10.05.2017**

Sek. Juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.